



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-7166 /2026

Klinë, datë 11/03/2026

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.28/2008, nenit 24 të Rregullores se QRK-së, nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, kryetari i komunës së Klinës mori këtë:

## V E N D I M

Për themelimin e Komisionit Komunal për Kthim

- THEMELOHET**, Komisioni Komunal për Kthim në Komunën e Klinës, në këtë përbërje si në vijim:
  - 1.1. Silvija Rashkoviq, ZKKK, Kryesuese;
  - 1.2. Hajdin Morina, DKA anëtarë;
  - 1.3. Asllan Berisha, DSHMS anëtarë;
  - 1.4. Lauretë Bekteshi Dakaj, QPS anëtarë;
  - 1.5. Rasim Elezaj, DSHPE anëtarë;
  - 1.6. Adem Sejdiu, DUMM, anëtarë;
  - 1.7. Greta Skeli, DKGJP, anëtarë, si dhe;
  - 1.8. Suada Koxhadish, MKK anëtarë.
- Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në Komisionin Komunal për Kthim nga radhët e donatorit rregullohet më marrëveshje në mes MKK-së, komunës dhe donatorit.
- UNHCR-ja ka rol këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.
- Komisioni Komunal për Kthim është i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllime të monitorimit.
- Mandati i anëtarëve të Komisionit caktohet për periudhën 3 vjeçare.
- Më rastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i kryetarit të komunës, nr.01-112-36017/2023 i datës 17.10.2023.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

### Te njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- Zyra e informimit;
- Ekzekutivi;
- IOM;
- MMK, si dhe;
- Arkivi;

Kryetari,  
Zenun Elezaj

